

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.R., nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPK, duke vendosur sipas ankesës të mbrojtësit së të akuzuarit, av. A.H., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.767/2017, të dt.23.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 10.12.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit S.R., av. A.H., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.767/2017, të dt.23.07.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.767/2017, të dt.23.07.2018, është shpallur fajtor i akuzuari S.R., për shkak të veprës penale lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me më gjobë, në shumë prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin më gjobë, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 25 ditë, duke i llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 euro.

E dëmtuara F.R., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej 20 euro, për dëgjimin e ekspertit shumë prej 50 euro, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 40 (dyzet) €, si dhe për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 (peshembëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit S.R., av. A.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të vendimit për dënim, duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të priset, dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.1007/2017, të datës 15.10.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit S.R., av. A.H., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.R., av. A.H., nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av.A.H., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se aktgjykimi është në kundërshtim me vetveten dhe arsyetimin e aktgjykimit, ngase shkaqet sipas të cilave është vendosur janë të pa qarta dhe të kundërta ne mesë të gjendjes faktike dhe asaj se çka është cekur në te, andaj si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të dispozitës ligjore nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPPK-së.

Kolegji i kësaj gjykate e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, si dhe shkresat e tjera të lëndës, për të cilat përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare se aktgjykimi i ankimuar a përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale në kuptim të nenit 394 të KPPK, për të cilat dhe ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse dispozitivi i aktgjykimit të aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten dhe me dispozitivin e të njëjtit, sepse përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare, të cilat karakterizojnë veprën penale për të cilat është akuzuar i akuzuari, e cila rezulton në bazë të provave personale dhe materiale. Nga aktgjykimi i ankimuar vihet në përfundim se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar të gjitha elementet inkriminuese të veprës penale lëndimi i lehët trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPK, sepse në këtë çështje penale më provat e proceduara dhe të vlerësuara është ardhur në përfundim se i akuzuari S.R., e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barë dhe se kolegji i kësaj gjykate, ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar është punuar në kuptim të nenit 370 par.6 lidhur me par.7 të KPPK, duke përmbajtur formën dhe përmbajtjen e kërkuar me shkrim. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë ka dhënë arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, duke dhënë arsye se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara apo të pa vërtetuara, si dhe në mënyrë të qartë ka paraqitur edhe saktësinë e secilës provë e cila e karakterizon çështjen penale, për zgjidhjen e së njëjtës, andaj, aktgjykimi gjykatës së shkallës së parë si i tillë është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë më asnjë provë nuk ka arritur që të vërtetoj se i akuzuari, ditën kritike e ka goditur të dëmtuarën-motrën e tij, e cila është e moshës se re dhe i njëjti është kujdesur gjithnjë për të njëjtën, për përgatitjen e martesës si dhe vendosjen e saj në shtëpinë familjare ku tani jeton e ëma dhe asnjëherë nuk ka pasur qëllim që të njëjtës ti shkakton lëndime të lehta trupore, duke shtuar se e dëmtuara F. pa kurrfarë arsye e ka sulmuar, duke bërtitur dhe duke bërë skena të ndryshme e njëherit duke e goditur veten, por gjykata nuk ka marr asnjë veprim për vërtetimin apo demantimin e këtyre deklaratave. Andaj, si rezultat i kësaj, gjykata e shkallës së parë është dashur që të vlerëson gjendjen faktike në mënyrë më përmbajtjesore, e jo vetëm nga vlerësimi i deklaratës së të dëmtuarës.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e

shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është vërtetuar nga provat e administruara dhe të vlerësuara, ka dëgjuar në cilësinë e të dëmtarës F. R.i, ka dëgjuar ekspertin mjeko-ligjor Dr. N.U., si dhe ka administruar provat materiale si raportin e oficerit A.I., më numër të rastit 2016-EA-459, të dt.12.05.2016, raportin mjekësor të Qendrës Emergjente të Spitalit Rajonal në Gjakovë, më nr.6324, të st.15.05.2016 në emër të dëmtuarës F.R., ekspertizën mjeko-ligjore të ekspertit mjeko-ligjor Dr. N.U. të dt.27.08.2016, raportin e oficerit A.Sh., më nr. të rastit 2016-EA-457 të dt.12.05.2016, raportin e oficerit A.Sh., më nr. të rastit, 2016-EA-459 të dt.12.05.2016, raportin emergjent mjekësor të Spitalit Regjional në Gjakovë, ekspertizën mjeko-ligjore të ekspertit mjeko-ligjor të dëmtuarës F.R., ekspertizën mjeko-ligjore të ekspertit mjeko-ligjor Dr.F.B., të dt.07.06.2016, si dhe ka dëgjuar të akuzuarin S.R.. Pas vlerësimit të provave materiale si dhe atyre personale, kolegji ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, andaj, kolegji i kësaj gjykate, dhe se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i pranueshëm edhe për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke mos cekur ndonjë arsye për këtë bazë ankimore, mirëpo kolegji i kësaj gjykate në kuptim të neni 385 të KPPK, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, se vepra penale për të cilën është akuzuar i akuzuari parashihet me ligjin e aplikueshëm, se nuk ekzistojnë rrethana që përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale dhe ndjekja penale, se gjykata në mënyrë të drejtë ka zbatuar ligjin i cili ka qenë aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, se gjykata ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj, aktgjykimi i ankimuar është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se një dënim i tillë është tejet i rëndë, dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ika pasur për bazë dhe nuk i ka vlerësuar, rrethanat lehtësuese gjatë marrjes së vendimit për dënimin.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me ankesën e ushtruar si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimit, vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari është familjar baba i katër fëmijëve, mbajtës i familjes 6 anëtarsh, se gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor ka pasur qëndrim korrekt dhe faktin se i njëjti për herë të parë ka ra ndesh më ligjin, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj në prani të këtyre rrethanave, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, sikurse pretendon mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e ushtruar, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqyrtuar nga ana e gjykatës shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.1001/2018 të datës 10.12.2018

B. profesionale
Leonita Lajçi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq